



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 454 Prot.

Tiranë, më 02.07 2015

VENDIM Nr. 73 datë 23.06.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.9, të datës 23.06.2015, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim* në kuadër të Shkollës së doktoraturës "*Sondazhe arkeologjike në Manastirin e Shën Kollit - Mesopotam*" miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Prof. Luan Përzhita (IA) dhe doktorant Reshat Gega,

VENDOSI:

- I. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim* në kuadër të Shkollës së doktoraturës "*Sondazhe arkeologjike në Manastirin e Shën Kollit - Mesopotam*" paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Prof. Luan Përzhita (IA) dhe doktorant Reshat, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Vazhdimi i gjurmimit dhe gërmimit të hapsirës së përcaktuar për këtë sondazh që në vitin 2014.
- II. Mbetet në fuqi vendimi i KKA nr. 318, datë 04.06.2014, pika II, për shmangjen e sondazhit nr. 3 pranë Kishës së Mesopotamit.
- III. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2015.
- IV. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rrugë "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: www.asha.gov.al